



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2023:196910  
Datë: 23.04.2024  
Numri i dokumentit: 05606023

**PA1.nr.49/24**

**NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS**, Departamenti i Përgjithshëm – kolegji i përbërë nga gjyqtarët Skender Çoçaj - kryetar i kolegjit, Ferit Osmani dhe Abdullah Ahmeti - anëtarë të kolegjit, me pjesëmarrjen e zyrtares ligjore Rrezarta Bala, në çështjen penale ndaj të akuzuarit Gj. B. , nga P., për shkak të veprës penale në Kanosja, nga neni 181 par.2 lidhur me par.1, të KPRK-së, duke vendosur sipas ankesës së mbrojtësit të të akuzuarit Gj. B. -av. R. B. , të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prizren, P.nr.1207/23, datë 27.11.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur, më datë 23.04.2024, mori këtë:

**A K T G J Y K I M**

Me aprovimin e pjesshëm të ankesës së mbrojtësit të të akuzuarit Gj. B. av. R. B. , **NDRYSHOHET**, aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prizren, P.nr.1207/23, datë 27.11.2023, vetëm sa i përket kohëzgjatjes së Masës së trajtimit – rehabilitimit të detyrueshëm në liri të personave të varur nga droga dhe alkooli, ashtu që Kolegji Penal i Gjykatës së Apelit, të akuzuari Gj. B. , për shkak të veprës penale në Kanosja, nga neni 181 par.2 lidhur me par.1, të KPRK-së, Masën e trajtimit me anë të rehabilitimit të detyrueshëm në liri të personave të varur nga droga ose alkooli të shqiptuar nga gjykata e shkallës së parë e merr si të vërtetuar dhe se e njëjta masë do të zgjasë për aq kohë sa është e nevojshme për trajtimin e të akuzuarit por jo më tepër se 2 (dy) vite.

Në pjesët tjera aktgjykimi i ankimuar ngel i pa ndryshuar.

**A r s y e t i m**

Gjykata Themelore në Prizren, me aktgjykimin, P.nr.1207/23, datë 27.11.2023, të akuzuarin Gj. B. e ka shpallur fajtor për shkak të veprës penale në Kanosja, nga neni 181 par.2 lidhur me par.1, të KPRK-së dhe e ka gjykuar me dënim me gjobë në shumë prej 1.460 ( njëmijë e katërqind e gjashtëdhjetë) € e në të cilin dënim do ti llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim 15.09.2023 deri me datën 27.11.2023 dhe Në mbështetje të nenit 83, 87 të KPRK-së, e lidhur me nenin 503 të KPPRK-së, të akuzuarit gjykata i shqipton, Masën e trajtimit me anë të rehabilitimit të detyrueshëm në liri të personave të varur nga droga ose alkooli. Masa e trajtimit për rehabilitim të detyruar psikiatrik në liri do të ekzekutohet në Institucionin e kujdesit shëndetësor-Qendra e Shëndetit Mendor në Prizren. Është obliguar i akuzuari që të paraqitet në institucionin e kujdesit shëndetësor për trajtim të detyruar psikiatrik sipas orarit dhe nevojës së përcaktuar nga institucioni i kujdesit shëndetësor-Qendra e Shëndetit Mendor të Spitalit Regjional “Prim Dr.“D. M: ” në P., pas pranimit të këtij aktgjykimi. Masa e trajtimit të detyrueshëm psikiatrik në liri do të zgjasë për aq kohë sa është e nevojshme për trajtimin e të akuzuarit. Nëse i akuzuari nuk i nënshtrohet trajtimit në liri, gjykata do të urdhërojë që trajtimi të ekzekutohet në institucionin e kujdesit shëndetësor. Institucioni i Kujdesit Shëndetësor- Qendra e Shëndetit Mendor në Prizren, obligohet ta pranojë në trajtim të akuzuarin sipas këtij aktgjykimi si dhe t’i dërgoi raport gjykatës së paku një herë në dy (2) muaj mbi gjendjen shëndetësore të akuzuarit si dhe nëse eventualisht ka nevojë që të ndërrohet masa ose e njëjta të ndërpritet. Është obliguar i akuzuari që të paguajë shpenzimet e procedurës penale aq sa bëhen sipas llogarisë së gjykatës, ndërsa në emër të paushallit gjyqësor shumë prej 20 (njëzet) €, dhe në emër të fondit për kompensimin e viktimave të krimit shumë prej 20 (njëzet) €, të gjitha në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit të dhunshëm. E dëmtuara, ka hequr dorë nga kërkesa pasurore juridike.

### **Kundër këtij aktgjykimi në afatin ligjor ankesë ka paraqitur :**

Mbrojtësi i të akuzuarit Gj. B. av. R. B. , për shkak të shkeljes së ligjit penal dhe vendimit përkitazi me urdhrin për shqiptimin e masës, duke i propozuar Gjykatës së Apelit të Kosovës, aktgjykimin e ankimuar të e ndryshoj ose të njëjtën të e anuloj dhe çështja të i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim.

Prokuroria e Apelit e Kosovës, me parashtresën PPA/II.nr.59/2024, të datës 17.01.2024, ka propozuar që të aprovet pjesërisht ankesa e mbrojtësit të të akuzuarit sa i përket kohëzgjatjes së matjes së trajtimit të detyrueshëm, aktgjykimi të anulohet dhe çështja të kthehet në rivendosje, ndërsa sa i përket sanksionit penal, aktgjykimi i ankimuar të vërtetohet.

Kolegji penal i Gjykatës së Apelit të Kosovës, pasi mbajti seancën e kolegjit, shqyrtoj shkresat e lëndës, vlerësoj pretendimet ankimore dhe analizoj aktgjykimin e ankimuar në kuptim të nenit 394 paragrafi 1 të Kodit të Procedurës Penale (KPP), konstatoj se :

### **- Ankesa është pjesërisht e bazuar.**

Nga përmbajtja e ankesës del se mbrojtësi i të akuzuarit Gj. B. av. R. B. e ankimon aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë sa i përket shkeljeve esenciale të dispozitave të

procedurës penale duke pretenduar që aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penal nga neni 384 par.2.7 të KPRK-së, ngase aktgjykimi nuk është përpiluar në pajtim me nenin 369 par.4 të KPRK-së. Në kuptim të nenit 370 par.4 të KPP-së, në rastet kur i akuzuari është dënuar, aktgjykimi duhet të përmban të gjitha të dhënat e nevojshme të parapara me nenin 364 par.2.4 të KPP-së, që nënkupton se dispozitivi, përpos tjerash duhet të përmban urdhrin për shqiptimin e masës së trajtimit të detyrueshëm rehabilitues të kryesve të varur nga droga dhe alkooli.

Kolegji Penal i kësaj gjykate vlerëson se pretendimet e lartë cekura të mbrojtësit të të akuzuarit qëndrojnë dhe janë të bazuara dhe se të njëjtat lidhet edhe me shkelje të ligjit penal në dëm të të akuzuarit. Me dispozitën e nenit 364 par.2 nënpar.2.1 të KPP-së, përcaktohet se në dënimin e shqiptuar të të akuzuarit, duhet të përfshirë edhe dënimin alternativ nga Kodi Penal si edhe me dispozitën e nenit 87 par.3, përcaktohet se krahas dënimin me gjobë, vërejtje gjyqësore, apo lirimit nga dënimi, trajtimi nuk mund të zgjas më tepër se dy vite. Në rastin konkret gjykata e shkallës së parë në aktgjykimin e saj krahas dënimin me gjobë i ka shqiptuar edhe Masën e trajtimit të detyrueshëm – rehabilitimin në liri të personave të varur nga droga ose alkooli, por nuk e ka përcaktuar saktë kohën se sa duhet të zgjasë kjo masë, ashtu siç kërkohet me dispozitat e lartë cekura ligjore, andaj kjo paraqet sipas vlerësimit të Kolegjit Penal të kësaj gjykate, shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale e që lidhen edhe me shkelje të ligjit penal në dëm të të akuzuarit e të cilat shkelje u evituan me ndryshimi e këtij aktgjykimi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjendja faktike nuk ka qenë objekt vlerësimi i kësaj gjykate, ngase në ankesë nuk ka mundur të kontestohet, sepse i akuzuari në shqyrtimin gjyqësor e ka pranuar fajësinë për të gjitha pikat e akuzës, edhe gjykata është pajtuar me një pohim të tillë, prandaj sipas nenit 383 par. 2 të KPPK-së, ndaj aktgjykimit që është marrë në bazë të pranimit të fajësisë ose marrëveshjes për pranimin e fajësisë nuk lejohet ankesa për gjendjen faktike, andaj aktgjykimi i ankimuar u vlerësua vetëm në frymën e pretendimeve ankimore sa i përket vendimit për dënim.

Mbrojtësi i të akuzuarit Gj. B. av. R. B. e ankimon aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë sa i përket shkeljes së ligjit penal, duke pretenduar që bazuar në nenin 87 par.1 të KPRK-së, të akuzuarit i është shqiptuar masa e sipërshënuar dhe në bazë të par.3 të nenit 87 të KPRK-së, nëse masa nga par.1 i këtij neni është shqiptuar krahas dënimin me gjobë, vërejtjes gjyqësore apo lirimit nga dënimi, trajtimi nuk mund të zgjas më tepër se dy vite. Masa e trajtimit të detyrueshëm rehabilitues në aktgjykimin e ankimuar, me konstatim se masa do të zgjas për aq kohë sa është e nevojshme për trajtimin e të akuzuarit, është bërë edhe shkelje e ligjit penal ngase nuk është caktuar afati maksimal i zgjatjes së kësaj mase siç është paraparë me nenin 87 par.3 të KPRK-së.

Kolegji Penal i kësaj gjykate, pretendimet e lartë cekura sipas vlerësimit, janë të bazuara dhe se të njëjtat u evituan me ndryshimin e këtij aktgjykimi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke e përcaktuar edhe kohën e saktë se sa në maksimum mund të zgjasë masa e shqiptuar nga ana e gjykatës së shkallës së parë. Duke u përkujdesur sipas detyrës zyrtare Kolegji Penal i kësaj gjykate nuk gjeti shkelje tjera e të cilat do të kishin kushtëzuar anulimin e këtij aktgjykimi. Në rastin konkret është aplikuar ligji që ka qenë në fuqi në kohën e kryerjes së veprës penale, drejtë

janë aplikuar edhe dispozitat mbi përcaktimin e llojit dhe matjes së lartësisë së dënimit, drejtë janë vlerësuar si rrethanat lehtësuese dhe ato rënduese dhe se dënimi i shqiptuar është i drejtë i ligjshëm dhe adekuat me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë penale të të akuzuarit.

Mbrojtësi i të akuzuarit Gj. B. av. R. B. e ankimon aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë sa i përket vendimit përkitazi me urdhrin për shqiptimin e masës, duke pretenduar që masa e trajtimit të detyrueshëm në liri ndaj të akuzuarit, do të zgjasë aq kohë sa është e nevojshme, për trajtimin e tij, pa ju përcaktuar afati maksimal prej dy vitesh, siç është paraparë në dispozitën ligjore, që nënkupton se mund të zgjasë edhe më tepër se dy vite. I propozon Gjykatës së Apelit të Kosovës, duke i propozuar Gjykatës së Apelit të Kosovës, aktgjykimin e ankimuar të e ndryshoj ose të njëjtën të e anuloj dhe çështja të i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim.

Sipas vlerësimit të kolegjit penal të Gjykatës së Apelit të Kosovës, pretendimet ankimore të paraqitura në ankesën e mbrojtësit të të akuzuarit, për ndryshimin apo anulimin e aktgjykimin, ndaj të akuzuarit, janë të bazuara. Kjo për faktin se gjykata e shkallës së parë në përgjithësi drejtë i ka konstatuar dhe vlerësuar rrethanat të cilat ndikojnë në caktimin e llojit dhe lartësisë së dënimit, ndërsa, gabimisht gjykata e shkallës së parë nuk e ka përcaktuar kohën e saktë se sa do të zgjasë masa e trajtimit të detyrueshëm psikiatrik – rehabilitimi nga përdorimi i drogave dhe alkoolit dhe me ndryshimin e aktgjykimin të gjykatës së shkallës së parë, duke e përcaktuar kohën e saktë se sa mund të zgjasë kjo masë u evituar edhe shkelja e ligjit penal në dëm të të akuzuarit. Kështu, gjykata e shkallës së parë me rastin e matjes së dënimit ndaj të akuzuarit e duke u bazuar konform të dispozitës së nenit 69 të KPRK-së, gjykata si rrethanë lehtësuese mori parasysh pranimin e fajësisë në shqyrtimin fillestar,- sjelljen e tij pas kryerjes së veprës penale, pendimin e tij dhe keqardhjen e shprehur ndaj të dëmtuarës dhe rastit të ndodhur, rrethanat personale se i njëjti është baba i dy fëmijëve, i gjendjes së dobët ekonomike, shkallën e përgjegjësisë penale, ku i akuzuari edhe nga raporti i Institutit të Forenzikës Psikiatrike, është konsideruar se në kohën e kryerjes së veprës penale, i akuzuari ka pasur përgjegjësi esencialisht të zvogëluar e që nënkupton se përgjegjësia e tij penale e një niveli shumë më të ulët sesa e një kryerësi i cili është plotësisht përgjegjës, si dhe premtimin e tij se në të ardhmen nuk do të përsërisë veprime të cilat bien ndesh me ligjin, ndërsa si rrethanë rënduese, gjykata gjeti se i njëjti ka qenë edhe me parë i dënuar me aktgjykim të plotfuqishëm të kësaj gjykate si P.nr.223/20 i plotfuqishëm me datë 12.06.2023 për veprën penale sulm nga neni 184 par. 1 të KPRK-së. Andaj, duke i pasur parasysh të gjitha rrethanat e lartcekura gjykata e shkallës së parë i shqiptoi të akuzuarit dënimin sikurse në dispozitiv të aktgjykimin të ankimuar me bindjen se edhe me një dënim të tillë do arrihet qëllimi i dënimit i paraparë me dispozitën e nenit 38 dhe 87 të KPRK-së. Një vlerësim të këtillë të rrethanave relevante për matjen e dënimit si të drejtë dhe të ligjshëm e pranon edhe kjo gjykatë dhe gjen se gjykata e shkallës së parë drejtë dhe në mënyrë të plotë i ka vlerësuar rrethanat të cilat ndikojnë në caktimin e llojit dhe lartësisë së dënimit, ndërsa rrethanat e pretenduara lehtësuese në ankesën e mbrojtësit të të akuzuarit, sipas vlerësimit të kësaj gjykate nuk janë të atij karakteri dhe nuk kanë ndikim që të akuzuarit t'i shqiptohet një dënim tjetër nga ai të cilin e ka shqiptuar gjykata e shkallës së parë apo që për të akuzuarin të e ndryshoj apo të e anuloj aktgjykimin, sikurse që pretendohet në ankesë, të gjitha këto rrethana sipas vlerësimit të kolegjit

penal të kësaj gjykate japin bazë të mjaftueshme që arsyetojnë shqiptimin e dënimit me gjobë nga gjykata e shkallës së parë si në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar, ndërsa sa i përket masës së trajtimit të detyrueshëm psikiatrik në liri – rehabilitimi i drogave dhe alkoolit duke e ndryshuar aktgjykimin si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, duke e përcaktuar kohën se sa mund të zgjasë kjo masë u evitua shkelja e ligjit penal në dëm të të akuzuarit, andaj duke marrë parasysh rrethanat e konstatuara dhe drejtë të vlerësuara nga ana e gjykatës së shkallës së parë, del se dënimi i shqiptuar me gjobë dhe masa e shqiptuar ndaj të akuzuarit janë në harmoni me intensitetin e rrezikshmërisë shoqërore të veprës së kryer penale, me shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit si ekzekutorë dhe se kjo do t'i shërbej preventivës gjenerale, posaçërisht asaj individuale, forcimit të moralit të shoqërisë, si dhe përgjegjësisë dhe disiplinës së qytetarëve, se me këtë kryerësi do të parandalohet nga kryerja e veprave penale në të ardhmen, si dhe do të bëhet rehabilitimi i tij. Andaj kolegji penal i kësaj gjykate konsideron se dënimi i shqiptuar është i mjaftueshëm për tu arritur qëllimi i dënimit i paraparë me dispozitën e nenit 38 dhe 87 të KPRK-së.

Duke u bazuar në këto që u cekën më lart dhe në bazë të nenit 403 të KPP, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

## **GJYKATA E APELIT E KOSOVËS**

### **Departamenti i Përgjithshëm**

PA1.nr.49/24, më datë 23.04.2024

**Zyrtarja ligjore;**

Rrezarta Bala

**Kryetari i kolegjit**

Skender Çoçaj

**Anëtarët e kolegjit:**

Ferit Osmani

Abdullah Ahmeti